



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Prill 2021

Nr: 281

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E VËZHguesve AFATSHKURTËR DHE PËRKTHYESVE TË AMBASADËS
POLAKE, AMERIKANE, NORVEGJEZE, MALAZEZE DHE KËSHILLIT TË EVROPËS
PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE
PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021.**

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Polake për akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Amerikane për akreditimin e 28 (njëzet e tetë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 30 (tridhjetë) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Norvegjeze për akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 3, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë kërkesën e Ambasadës së Malit të Zi për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi
5. Të miratojë kërkesën e Zyrës së Këshillit të Evropës për akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Illirjan CELIBASHI

